




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E MJEDISIT

DREJTORIA E NATYRËS DHE PYJEVE

Nr. 888/2 Prot.



Nr. 773 prot. Dt. 13.03.2025 Datë 11.3 2025

Lënda:

Mbi miratimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore "Iballë-Mzi",
Bashkia Fushë-Arrëz

Z. Hil CURRI

Kryetar

BASHKIA FUSHË-ARRËZ ✓

Qendër, "Fushë-Arrëz"

I nderuar Z. Curri,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.260 Prot., datë 30.01.2025 "Dërgim i Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave "Iballë-Mzi", drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, pas shqyrtimit të dokumentacionit (shkresa përcjellëse, Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.67, datë 23.12.2024, konfirmimin e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Shkodër me nr.8/3 Prot, datë 23.01.2025, relacionin e strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki dhe plani i mbarështimit në formë print dhe elektronike) bashkëlidhur, ju bëjmë me dije se:

Struktura e planit të mbarështimit për ekonominë pyjore "Iballë-Mzi", me sipërfaqe të përgjithshme prej 4031.1 ha (1577.2 ha, pyll; 2193.4 ha, me bimësi pyjore, etj.; 14.5 ha, kullotë dhe 246 ha, sipërfaqe të zëna me miniera dhe sipërfaqe ndihmëse për to) është e bazuar në Udhëzuesin "Për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", me objektivat kryesore e specifike që orientojnë ekonominë pyjore drejt menaxhimit të duhur, duke angazhuar dhe përfshirë komunitetin për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor, në pronësi të bashkisë.

Plani i mbarështimit dhe përmbajtja e tij, vijonë në përputhje me udhëzimet teknike e ligjore të hartimit e miratimit të tyre ashtu edhe me objektivin për menaxhim të qëndrueshëm. Më konkretisht, struktura e planit të hartuar është e duhura, analiza e grumbujve pyjore me treguesit dendrometrikë është e plotë, fletët (skedat) e përshkrimit të ngastrave përputhen me shtjellimin e tyre në plan, ndërhyrjet janë konkrete, nominalisht për ngastër dhe sipas urgjencës.

Gjithashtu shtrirja gjeografike dhe vendosja e sipërfaqeve prove të përhershme në të, detajohen dhe pasqyrohen mirë. Të dhënat për moshën janë të plota, sipërfaqet pasqyrohen njëjloj, jepen medotat e llogaritjes së mundësisë së shfrytëzimit, hartat e ekonomisë pyjore me rrjetin e

pikave të sipërfaqeve të përhershme, tipeve të pyjeve e kullotave, funksioneve, ndërhyrjeve, rrjetit rrugor, infrastrukturës dhe zonave të degraduara, janë sipas udhëzuesit.

Sa më sipër dhe bazuar në germën (b), pika 2, neni 11, të ligjit 57/2020, dat 30.4.2020, “Për pyjet”, konfirmojmë për zbatim planin 10-vjeçar të mbarështimit, për ekonominë pyjore “Iballë-Mzi”, pjesë përbërëse e fondit pyjor në pronësi të bashkisë Fushë-Arrëz.

Njëkohësisht duke vlerësuar hapat e ndërmarrë nga ju, lidhur me miradministrimin e fondit pyjor e kullosor në bashkinë tuaj, kërkojmë vazhdimin e hartimit të planeve të mbarështimit dhe realizimit të investimeve me fondet e vetë bashkisë.

Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, të bëjë përditësimet përkatëse në regjistrin e fondit pyjor dhe hedhjen e të dhënave në sistemin “ALFIS”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTËR
MIRELA KUMBARO BURXHI

